



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Këshilli Drejtues të Universitetit

Pejë, __.11.2025

Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur më 14.11.2025, mori vendim të shpallë:

KONKURS

Për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2025/26

I. Kushtet e përgjithshme

1. Bursat universitare ndahen për studentët e nivelit të studimeve baçelor dhe master.
2. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
 - 2.1. Të jenë studentë të rregullt të fakulteteve të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
 - 2.2. Të jenë të regjistruar së paku në vitin e dytë të studimeve;
 - 2.3. Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
 - 2.4. T'i kenë të përfunduara të gjitha provimet e parapara për vitin përkatës të studimeve, deri në afatin e shtatorit të vitit akademik 2024/25;
 - 2.5. Të kenë notë mesatare jo më të ulët se nëntë (9).
3. Për studentët e huaj që nuk janë studentë të rregullt si në nën-pikën 2.1, Këshilli Drejtues, mund të vendosë me vendim të veçantë për bursa të caktuara, pas përfundimit të mobilitetit të studentëve.

II. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (I) e këtij konkursi, aplikimin duhet të bëjnë përmes platformës elektronike SMU, në vegzën: **smu.unhz.eu**
2. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:
 - 2.1 Kërkesës për aplikim (Fletë aplikacioni), e cila shkarkohet nga platforma elektronike SMU, pas aplikimit online.
3. Studenti obligohet që Fletë aplikacionin ta printojë dhe ta dorëzojë në Zyrën për Protokollim dhe Arkiv të fakultetit përkatës, si dëshmi për aplikimin brenda afatit të paraparë në këtë konkurs.

4. Fakultetet janë të obliguara që në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë konkurs t'i përgatisin listat e studentëve të cilët i plotësojnë kriteret për fitimin e bursës universitare dhe t'i përcjellin me shkresë përcjellëse në Zyrën për Çështje Studentore në Administratën Qendrore, brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orësh nga dita e përfundimit të konkursit. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave dhe dërgimin e dokumentacionit brenda afatit, e bartin sekretarët e fakulteteve.
5. Zyra për Çështje Studentore në Administratën Qendrore, kontrollon rregullsinë e dokumentacionit të pranuar dhe e përcjell në Këshillin Drejtues për shqyrtim dhe miratim.
6. Bursat universitare u ndahen studentëve të niveleve baçelor dhe master, për rezultatet akademike të arritur gjatë vitit akademik 2024/25, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë thirrje.
7. Lartësia e bursës përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues.

III. Mënyra dhe afati i aplikimit

1. Aplikimi bëhet përmes platformës elektronike SMU, në vegzën: **smu.unhz.eu**, prej datës **17.11.2025** deri me datë **21.11.2025, në orën 16:00**.
2. Lidhur me problemet eventuale teknike gjatë aplikimit, të kontaktohet Zyra për Teknologji të Informacionit e Administratës Qendrore, përmes adresës zyrtare elektronike: **web@unhz.eu**.

IV. Afati i ankesave

1. Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e studentëve përfitues të bursës, kanë të drejtë ankese në afat prej dyzet e tetë (48) orësh pas ditës së publikimit të listave.
2. Ankesat dorëzohen në Zyrën për Protokollim dhe Arkiv (nr. 13), Ndërtesa e Rektoratit, Rr. UÇK, 30000, Pejë, Republika e Kosovës.
3. Ankesat e pasafatshme nuk do të merren në shqyrtim.

V. Publikimi

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve, ueb faqet e fakulteteve, si dhe në ueb faqen e Universitetit: **www.unhz.eu**.